



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.21/2018
Prishtinë, më 27.3.2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Hykmete Bajrami, Dardan Molliqaj, Mimoza Kusari – Lila dhe Gani Dreshaj, anëtar.

Munguan: Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Memli Krasniqi, Bilall Sherifi dhe Duda Balje, anëtare.

Pjesëmarrës të tjerë: Rexhep Bllaca, Isa Elshani, Gurakuq Kastrati dhe Artan Demolli- MTI; Vitomir Fister – FMG-Projekt/MTI; Amir Kozmaqi, INDEP; Egzon Osmanaj, KDI dhe Florina Syla, “Ekonomia Online”.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1.Miratimi i rendit të ditës;
- 2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.3.2018;
- 3.Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin nr. 06/L-031 për Pajisjet nën Presion;
- 4.Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr. 06/L-037 për Metrologji;
- 5.Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr. 06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit;
- 6.Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.3.2018.

Procesverbali i mbledhjes së datës 19.3.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin nr. 06/L-031 për Pajisjet nën Presion

Kryetarja: Komisionet e përhershme nuk kanë dhënë ndonjë vërejtje për këtë projektligj, andaj, raporti me rekomandime të shkojë në lexim të dytë në Kuvend.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

1.Miratohet raporti me rekomandime i Projektligjit nr. 06/L-031 për Pajisjet nën Presion.

2. Raporti me rekomandime t'i procedohet Kuvendit për lexim të dytë.

4.Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr. 06/L-037 për Metrologji

Kryetarja tha se shqyrtimi i këtij projektligji dhe projektligjit tjetër që e kemi në pikën tjetër, janë dy projektligjeve të parapara edhe në Agjendën për Reforma Evropiane (ERA) që priten të miratohen nga Kuvendi më 30.3.2018, dhe si të tilla duhet të procedohen në komisionet e përhershme për vlerësim, sipas kompetencës. Grupi i punës e ka amendamentuar këtë projektligj dhe ka paraqitur raport me amendamente, ku ia dha fjalën deputetes, znj. Mimoza Kusari- Lila, si kryesuese e grupit punues.

Mimoza Kusari- Lila tha se grupi punues e ka përfunduar amendamentimin dhe nuk ka pasur ndryshime substanciale dhe kemi miratuar 19 amendamente, kryesisht janë të aspektit tekniko-juridik. Ajo propozoi që, nëse nuk ka ndonjë vërejtje rreth amendamenteve, t'i votojmë në bllok.

Propozimi i znj. Kusari- Lila u përkrah nga komisioni.

Pas debatit, komisioni nxori këtë:

Përfundim

1.Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 06/L-037 për Metrologji.

2.Raporti me amendamente i Projektligjit nr.06/L-037 për metrologji, procedohet në komisionet e përhershme për vlerësim, sipas kompetencës.

Raporti me amendamente i bashkëngjitet këtij procesverbal.

5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin nr. 06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit

Kryetarja theksoi se grupi i punës ka amendamentuar edhe këtë projektligj dhe ka paraqitur këtë raport me amendamente. Raportin me amendamente do ta paraqesë deputetja znj. Hykmete Bajrami, si kryesuese e grupit punues.

Hykmete Bajrami tha se grupi i punës e ka shqyrtuar Projektligjin dhe i kemi hartuar 13 amendamente. Por pas konsultimeve që pata më ekspertin e kësaj çështje, propozoi që të hiqet amendamente 7, pasi që shprehja e interesit e cila duhet të bëhet publike, duke siguruar konkurrencë të lirë për të gjithë të interesuarit që plotësojnë kushtet, nuk po gjen harmonizim edhe në terminologjinë e projektligjit. Ndërsa, më propozim të ministrisë, Amendamenti 2 ndryshohet, ku në vend të “Komisionit profesional” vendoset “Agjencia Kosovare e Standardizimit”, si dhe shtohet një Amendament i ri, në nenin 8, ku shtohet një paragraf i ri, si rezultat i këtij ndryshimi.

Propozimet e znj. Hykmete Bajrami, u përkrahen nga komisioni.

Pas debatit, komisioni nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit.*
- 2. Raporti me amendamente i Projektligjit nr. 06/L-041 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit, procedohet në komisionet e përhershme për vlerësim, sipas kompetencës.*

Raporti me amendamente i bashkëngjitet këtij procesverbali.

6. Të ndryshme Çështjet vijuese

Kryetarja njoftoi anëtarët e komisionit lidhur me vizitën në KOSTT, ku ka qenë më znj. Mimoza Kusari - Lila, që është realizuar me iniciativën e KDI-së, lidhur me zbatimin e marrëveshjeve me Serbinë në fushën e energjisë.

Mimoza Kusari - Lila propozoi që lidhur më këtë çështje të ftohet KOSTT-i dhe ZRRE-ja që të raportojnë në komisionin, pasi që duhet të koordinohen në mes vete.

Komisioni vendosi që mbledhja e radhës të mbahet më:29.3.2018, në orën 10:00.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Për: Komisionet e përhershme të Kuvendit të Republikës së Kosovës;
Komisioni për Buxhet dhe Financa;
Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim;
Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit;
Komisioni për Integritet Evropian;

Nga: Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal;

Lënda: Raporti me Amendamente i Projektligjit nr.06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit;

Datë: 27.3.2018, Prishtinë;

Në bazë të nenit 57 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal, me datë 27.3.2018, e shqyrtoi dhe amendamentoj Projektligjin nr.06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit për vlerësim sipas kompetencës, si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 2, paragrafi 2, fshihet fjalia “ose autorizimin”.

Amendamenti 2

Neni 5, paragrafi 2, ndryshohet si vijon:

2. Ministri përkatës, me rekomandim të Agjencisë Kosovare të Standardizimit, me vendim largon standardin e harmonizuar të Kosovës nga lista e standardeve të referuara në nenin 8 paragrafi 2 të këtij ligji, nëse vërtetohet se mungesa e sigurisë së produktit të referuar në paragrafin 1 të këtij neni është rezultat i zgjidhjeve të papërshtatshme teknike të standardit të tillë.

Amendamenti 3

Neni 8 paragrafi 3, referenca “nga paragrafin 1 i këtij neni” zëvendësohet më “nga paragrafi 2 i këtij neni”.

Amendamenti 4

Neni 8, pas paragrafit 3, shtohet një paragraf i ri si vijon:

4. Ministri i ministrisë përkatëse me rekomandim të Agjencisë Kosovare të Standardizimit, merr vendim për publikimin e Listës me standarde të harmonizuara në Gazetën Zyrtare.

Amendamenti 5

Neni 12, pas paragrafit 7, shtohet një paragraf i ri 8, si vijon:

Forma, përmbajtja e shenjës së konformitetit përcaktohet me akt nënligjor nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Amendamenti 6

Neni 13, paragrafi 1 ndryshohet si vijon:

1. Kur me rregullore teknike përcaktohet se i gjithë, ose një pjesë e vlerësimit të konformitetit, duhet të kryhet nga një trup i emëruar për vlerësimin e konformitetit (në tekstin e mëtejshëm: trupi i emëruar), vendimi për emërimin e tij lëshohet nga ministri i ministrisë përkatëse, pasi që është dhënë rekomandimi nga Komisioni kompetent, i cili rekomandim ndër të tjera garanton së trupa i ka përmbushur të gjitha kushtet e parapara sipas këtij Ligji dhe akteve nënligjore, që burojnë nga ky Ligj, Kjo procedurë duhet të jetë sipas rregullave teknike përkatëse.

Amendamenti 7

Neni 13, pas paragrafit 4, shtohet një paragraf i ri si vijon:

“5. Procedura për mënyren e emërimit të trupave për vlerësim të konformitetit, rregullohet me akt nënligjor të nxjerr nga Qeveria.”

Amendamenti 8

Neni 14, ndryshohet si vijon:

1. Aplikacioni i dorëzuar për emërim shoqërohet me një përshkrim të aktiviteteve për vlerësimin e konformitetit, "modulit" ose "moduleve" për vlerësimin e konformitetit dhe të produktit ose produktëve për të cilat trupi pretendon të jetë kompetent.

2. Akreditimi është kërkesë e detyrueshme sipas nenit 16 paragrafi 2 të këtij ligji. Përveç për produktet që mbulohen me rregullore përkatëse ku akreditimi bëhet i obligueshëm, dy (2) vite pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Amendamenti 9

Neni 28, paragrafi 2, pas fjalës “të huaj” shtohet fjalia “pas rekomandimit të Komisionit Profesional.”.

Amendamenti 10

Neni 46, paragrafi 1, fjala “rikthehen,” zëvendësohet me “kthehen”.

Amendamenti 11

Neni 46, paragrafi 3, riformulohet si vijon:

3. Gjatë kryerjes së vlerësimit të riskut nga paragrafi 2 i këtij neni, fakti se mund të arrihen nivele më të larta sigurie apo se ka produkte të tjera më pak të sigurta, nuk janë arsye për ta konsideruar produkt me rrezik serioz.

Amendamenti 12

Neni 59, në paragrafin 2, referenca “Nenet 22 dhe 52” zëvendësohet me “Nenet 22 51 dhe 52 të këtij Ligji.”

Amendamenti 13

Neni 61, nënparagrafët 1.14, zëvendësohet me tekstin; “1.14. RREGULLORE NR. (MTI) NR. 01/2018 PËR ETIKETIMIN DHE SHËNJIMIN E PRODUKTEVE TË TEKSTILIT.” Ndërsa, fshihën nënparagrafet: 1.15 dhe 1.20.

Kryetarja e Komisionit

Sala BERISHA SHALA



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Për: Komisionet e përhershme të Kuvendit të Republikës së Kosovës;
Komisioni për Buxhet dhe Financa;
Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim;
Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit;
Komisioni për Integritet Evropian;

Nga: Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal;

Lënda: Raporti me Amendamente i Projektligjit nr.06/L-037 për Metrologji;

Datë: 27.3.2018, Prishtinë;

Në bazë të nenit 57 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal, me datë 27.3.2018, e shqyrtoi dhe amendamentoj Projektligjin nr.06/L-037 për Metrologji, dhe, procedon në Komisionet e përhershme për vlerësim sipas kompetencës, si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 3, nënparagrafi 1.3. riformulohet si vijon:

1.7.Mjetet matëse - në kuptimin e VIM-it, është termi që mbulon mjetet matëse të cilat mund të jenë objekt i kërkesave specifike dhe vlerësimit specifik të konformitetit, si vijon:

Amendamenti 2

Neni 3, nënparagrafi 1.14. riformulohet si vijon:

1.14. “Verifikimi i rregullt” - verifikimi i një mjeti matës pas verifikimit të mëparshëm. Verifikimi i rregullt përfshinë: verifikimin e detyrueshëm periodik, verifikimin pas riparimit dhe verifikimin vullnetar;

Amendamenti 3

Neni 3, nënparagrafi 1.31., riformulohet si vijon:

1.31. Emërimi – autorizim shtetëtor i një trupi për vlerësim të konformitetit që të kryen aktivitet të caktuar për vlerësim të konformitetit;
Ky ndryshim vlenë për tërë tekstin e Projektligjit.

Amendamenti 4

Neni 5, paragrafi 5, riformulohet si vijon:

5. Ligji për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës do të zbatohet për themelimin, organizimin dhe funksionimin e AMK-së.

Amendamenti 5

Neni 7, bartët tek neni 6, dhe paragrafet organizohen si vijon: paragrafi 1 i Nenit 7 fshihet; paragrafi 4 i Nenit 7, bëhet paragraf 2 i Nenit 6; paragrafi 2 i Nenit 7 bëhet paragraf 3 i Nenit 6; dhe, paragrafi 3 i Nenit 7, bëhet paragraf 4 i Nenit 6.

Amendamenti 6

Neni 9, paragrafi 2, fjala “departmentet” zëvendësohet me “strukturat”.

Amendamenti 7

Fshihet fjalia “KAPITULLI III NJËSITË MATËSE LIGJOR” ndërsa, Neni 10, titullohet “Njësitë matëse ligjore”.

Amendamenti 8

Neni 14, paragrafi 3, fjala “mund” zëvendësohet me “duhet”.

Amendamenti 9

Neni 20, paragrafi 2, fjala “mund” zëvendësohet me “duhet”.

Amendamenti 10

Neni 24, paragrafi 4, riformulohet si vijon:

“4. Verifikimi i mjeteve matëse ligjërish të kontrolluara mund të jetë fillestar, i rregullt, jo i rregullt dhe i jashtëzakonshëm.

Amendamenti 11

Neni 34, paragrafi 4, shkurtesa “SHEM” zëvendësohet me “shisheve si enë matëse”.

Amendamenti 12

Titulli i Nenit 43, riformulohet si vijon:

Neni 43 Inspektimi, mbikëqyrja dhe vëzhgimi

Amendamenti 13

Neni 43, paragrafi 2, riformulohet si vijon:

2. Mbikëqyrja e tregut në fushën e metrologjisë dhe mbikëqyrja metrologjike kryhet nga inspektorët të cilët e kanë njohuri përkatëse për mjetet matëse dhe për procesin të cilin e mbikëqyrin.

Amendamenti 14

Neni 43, paragrafi 4 rregullohet teknikisht duke u bërë paragraf 3, ndërsa fjala “Ata” zëvendësohet me “inspektoret”.

Amendamenti 15

Neni 43, paragrafi 8, fshihet teksti me kllapa “(në kuadër të kërkesave kushtetutare shtetërore)”.

Amendamenti 16

Neni 43, paragrafi 11, riformulohet si vijon:

11. Inspektorët e metrologjisë janë të autorizuar që të shqiptojnë masat administrative dhe kundërvajtëse.

Amendamenti 17

Neni 44, paragrafi 1, riformulohet si vijon:

1. Kundër vendimit të AMK-së, pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në Komisionin për shqyrtimin e ankesave (në tekstin e mëtejme: Komisioni), në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Amendamenti 18

Neni 47, paragrafi 2, organizohet si nënparagraf 1.1.; pas fjalës “personi” shtohet fjalia “fizik dhe personi”, i njejtë ndryshim vlen edhe për paragrafin 3 dhe 4.

Amendamenti 19

Neni 47, paragrafi 4, referenca “nenit 38 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.3. të këtij ligji.” zëvendësohet me “nenit 43 paragrafi 4. nën-paragrafi 4.1. të këtij ligji.”.

Kryetarja e Komisionit

Sala BERISHA SHALA